



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

VENDIM
nr.368, datë 16/06/2015

Për

ndreqje gabimi material në Vendimin nr. 366, datë 04.06.2015 të Komisionit të Konkurrencës “Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit”

Komisioni i Konkurrencës me përbërjen e:

- | | | |
|------------------|--------------------|--------------------|
| • Lindita | MILO (LATI) | Kryetare |
| • Servete | GRUDA | Zv/Kryetare |
| • Koço | BROKA | Anëtar |
| • Iva | ZAJMI | Anëtare |
| • Eduard | YPI | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 16.06.2015, me pjesëmarrjen e Znj.Lindita Milo (Lati), Znj. Servete Gruda, Z. Koço Broka, Z. Eduard Ypi, trajtoi çështjen me:

Objekt: Për ndreqjen e një gabimi material në Vendimin nr. 366, datë 04.06.2015, të Komisionit të Konkurrencës, “Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit”.

Baza ligjore: Neni 120 i Kodit të Procedurës Administrative;
Neni 24, gërma (d) i Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës nr. 86 prot., datë 16.06.2015, për një ndreqje gabimi në Vendimin nr. 366, datë 04.06.2015, të Komisionit të Konkurrencës;

VËREN SE:

Gjatë procesit të zbardhjes ka ndodhur një gabim material në lidhje me datën e shprehur në rrjeshtin 5, të pikës I të dispozitivit në Vendimin nr. 366, datë 04.06.2015 të Komisionit të Konkurrencës, e cila duhet të ishte 01.07.2015. Referuar sa më sipër, propozimi për një ndreqje gabimi në Vendimin nr. 366, datë 04.06.2015, të Komisionit të Konkurrencës, është i bazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në Neni 120 të Kodit të Procedurës Administrative dhe nenin 24, gërma (d) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Në pikën (I) të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 366, datë 04.06.2015, “Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rritit”, data “**01.07.2016**” **zëvendësohet** me datën “**01.07.2015**”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi për palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Eduard YPI

(_____)

(_____)

(_____)

(_____)

Zv/Kryetare

Anëtar

Anëtare

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R E